



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), nenin 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 17 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, nenin 17 të Rregullores QRK 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të neneve 15 paragrafi 2.4, dhe nenit 17 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më datë 31 korrik 2024 miratoi këtë;

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia Kadastrale P-1381-1 në Zonën Kadastrale Dobërdol

Neni 1

Formohet komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës për dhjetë (10) vite sipas vendimit nr.prot.01-463/06-0050249/24 të datës 31 korrik 2024 për miratimin paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik pronën e paluajtshme të Komunës: Njësia kadastrale P-1381-1 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Dobërdol, në sipërfaqe 81036 m², kulura Kullosë, klasa 3, vendi i quajtur "Boka", me destinim sipas Hartës Zonale-Zonë Pyjore, në këtë përbërje;

1. **z.Fitim Muçolli**, nga Kuvendi i Komunës
2. **z.Qëndrim Softolli**, nga Kuvendi i Komunës
3. **znj.Lirie Hoti**, nga Ekzekutivi i Komunës
4. **z.Bahri Selimi**, nga Ekzekutivi i Komunës
5. **z.Fatmir Halimi**, nga sektori joqeveritar lokal

Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni dhe i njëjti organizon dhe kryeson punën e komisionit.

Neni 2

Mandati i Komisionit është i përkohëshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, përkatësisht për zbatimin e vendimit nr.prot.01-463/06-0050249/24 datë 31 korrik 2024 të Kuvendit të Komunës për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës të paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe Rregulloren QRK 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Drejtoritë dhe shërbimet tjera përkatëse të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje këtij komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 6

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 9 paragrafi 8 të rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren Nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-020/04-0050253/24
Podujevë, datë, 31-07-2024

